

TEMATIKA E MISTICIZMIT ISLAM NË POEZINË E BEJTEXHINJËVE

Kontaktet e para të shqiptarëve me Islamin datojnë para ardhjes së turqëve në trojet shqiptare. Ato ishin kontakte më të hershme të Evropës, pra edhe të shqiptarëve me arabët respektivisht me islamin.¹ Por, sado që paraqitja e Islamit dhe e kulturës islame ndër shqiptarët ndodh para ardhjes së turqëve në Ballkan, njohja e drejtpërdrejtë e shqiptarëve me Islamin bëhet pas kontakteve të tyre me turqit osmanlinj, pra pasi që trojet shqiptare futen nën sundimin osman. Pas rënies nën sundimin osman shqiptarët me të madhe fillojnë të islamizohen, dhe për këtë ndikonin rrethana e faktorë të ndryshëm. Natyrisht që dervishët endacak dhe tarikatet kanë luajtur rol të rëndësishëm edhe në islamizimin dhe ngritjen kulturore, shkencore e artistike të shqiptarëve, pra në zhvillimin e jetës kulturore islame. "Ato i kanë dhënë ngjyrë dhe ton të posaçëm atmosferës shoqëro-politike dhe fetare në viset tona"².

Prandaj detyrë parësore e jona është edhe grumbullimi, studimi dhe botimi i trashëgimisë së shkruar në gjuhët orientale arabisht, persisht e turqisht, e të mos flasim për krijimtarinë letrare të shkruar shqip me grafi arabe. Kemi parasysh trashëgiminë kulturore shqiptare islame, e cila është një nga shtyllat themelore të karakteristikave kulturore dhe kombëtare të popullit shqiptar.

Hulumtimi dhe studimi i kulturës shpirtërore e materiale dhe të trashëgimisë kulturore të popullit tonë, e cila ka lindur si rezultat i jetës së përbashkët shumëshekullore me popujt musliman nën Perandorinë osmane si dhe me frytet e saj kulturore me kulturën tonë autoktone duhet të bëhet në mënyrë të institucionalizuar. Dhe kjo trashëgimi shpirtërore e materiale e shqiptarëve e lënë në vepra të ndryshme në gjuhët orientale e në gjuhën shqipe padyshim që ishte një kontribut i çmuar dhe me vlerë të konsiderueshme për kohën e vet në kulturën orientale. Por siç konstaton edhe G. Shpuza: "Kjo pasuri me vlera të shumanshme deri vonë nuk u muar

¹ . Nexhat Ibrahim, **Kontaktet e para të islamit me popujt ballkanikë në periudhën paraosmane**, Shkup, 1997, fq. 102.

² . Metin Izeti, **Tarikati Bektashian**, Tetovë, 2001, fq. 68.

parasysh, sepse ajo nuk konsiderohej pjesë e kulturës shqiptare për rjedhojë as pjesë e historisë së saj"³.

Megjithatë tash viteve të fundit ka filluar të mendohet ndryshe për këtë trashëgimi të begatshme kulturore, dhe kjo po bëhet preokupim më i shpeshtë i studiuesve⁴ të cilët e çmojnë dhe e vlerësojnë nivelin intelektual të atyre shqiptarëve që krijuanë në gjuhët orientale dhe kontribuan në zhvillimin e kulturës, dijes dhe në veçanti, letërsisë në gjuhët orientale dhe i vejnë në pah lidhjet me karakter të ndërsjellë të kulturës shqiptare me kulturën orientale-islame.

Kështu, mbi bazë të kësaj trashëgimie të shumtë kulturore, shkencore, fetare-islame, letrare e filozofike, të shkruar në gjuhët orientale, fillon të shkruhet edhe poezia shqipe me grafi arabe. Dhe kjo poezi shqipe e shkruar me grafi arabe, ose poezia e bejtexhinjëve siç njihet në letërsinë tonë, ishte poezi e qarqeve të caktuara intelektuale, por që përhapej shpejt, në një anë për shkak se tashmë nëpër të gjitha qendrat e mëdha kishte numër të konsideruar intelektualësh, të formuar në medresetë e shumta që funksiononin nëpër ato qendra dhe të cilët pëlqenin artin poetik dhe merreshin me përkthimin e veprave të njohura poetike sidomos persiane, por edhe të atyre arabe e turke, dhe në anën tjetër edhe për shkak se kultura islame ishte përhapur në popull dhe se ajo më nuk ishte e huaja për ta, sepse tashmë shqiptarët me shumicë i përkisnin fesë islame dhe rrjedhimisht edhe kësaj kulture.

Letërsia shqipe e shkruar me grafi arabe nuk lind rastësisht. Ajo lind në mjediset urbane ku kishte intelektual dhe një masë që dinin shkrim leximin arab, në mjediset ku ishin formuar qarqet kulturore ku vepronin medrese të shumta. Ajo lindi si nevojë e kohës pasi që ata krijues që deri dje krijonin në gjuhët orientale e panë se për të komunikuar me masat duhej krijuar në gjuhën amtare. Dhe kështu fillon të krijohet një poezi shqipe e ndikuar nga poezia orientale-islame si për nga forma e motivet edhe për nga teknika poetike, por që për lexuesit kjo teknikë poetike dhe këto forma e motive poetike nuk ishin të panjohura ngase ata poezi të këtillë kishin lexuar e dëgjuar në gjuhët orientale dhe nuk do mend se në atë kohë alfabeti arab ishte më i përhapuri ndër shqiptarët. Kjo poezi shqipe e shkruar me grafi arabe do të krijohet plot dy shekuj nga e cila do të trashëgojmë vepra të

³ Gazmend Shpuza, "*Jeta letrare në gjuhët orientale në Shqipëri*", **Perla**, 2001, nr. 1-4, Tiranë, fq. 3.

⁴ Gazmend Shpuza, *Jeta letrare në gjuhët orientale në Shqipëri*, në: **Perla**, 2001, nr. 1-4, fq. 3-13; Shaban Sinani, *Dorëshkrime orientale dhe tradita kulturore e Shqipërisë*, **Perla**, 2001, nr. 1-4, fq. 24-38; shih edhe: Hasan Kaleshi, *Roli i shqiptarëve në letërsinë orientale*, në: **Seminari i kulturës shqiptare për të huaj**, 2/1967, Prishtinë, fq. 151-217. (Fakulteti Filozofik). Shih edhe në: Hasan Kaleshi. **Kontributi i shqiptarëve në dituritë islame**, Prizren, 1991, fq. 112. etj..

bukura poetike me vlera të çmueshme artistike me autorët e njohur të kësaj pjese të letërsisë së vjetër shqipe si: Ibrahim Nezimi, Hasan Zyko Kamberi, Muhamed Çami, Zenel Bastari, Dalip Frashëri e të tjerë dhe të cilët letërsinë shqipe e pasuruan si me tema të reja që trajtuan si përshkrimi, satira, panagjirika, ashtu edhe me forma të reja poetike, si mesnevia (poema), kasida (vjershë e gjatë-oda), ilahia (vjershë fetare), gazeli (lirika) e të tjera.

Ne në këtë shkrim dëshirojmë të vëmë në dukje tematikën e misticizmit islam dhe disa tipare të ndikimit të letërsisë orientale-islame në atë të bejtexhinjëve shqiptarë. Poezia e bejtexhinjëve ka qenë më pak e ndriçuar, e trajtuar në mënyrë të sipërfaqshme dhe disa herë e interpretuar në mënyrë të gabuar. Studiuesit tanë më tepër janë marrë me aktivitetin shoqëror e politik të shkrimtarit sesa me krijimtarinë letrare e artistike të tij.

Rruga e formimit të poetëve bejtexhinj ishte medreseja në vise të ndryshme të Shqipërisë, dhe një numër sosh edhe kishin vazhduar studimet islame në Stamboll, e në ndonjë qendër tjetër, ku qëndronin me vite të tëra. Në qendrat e tilla ata paiseshin me nhjohuri të shkëlqyeshme Islame, kulturës dhe rrymave të mendimit islam, sidomos mësonin shumë për krijuesit letrar e filozofët arabë, persianë e turqë, mendimet dhe pikëpamjet e të cilëve do të na reflektohen edhe në krijimtarinë e tyre letrare. Pikërisht njohja e tyre e mrekullueshme e thesarit të pasur të letërsisë orientale-islame (arabe, perse e turke) bënë që ata të formoheshin e të kompletoheshin si poetë të mirë të kohës që njihnin shumë mirë artin poetik.

Bejtexhinjtë, si në mbarë poezinë islame, zakonisht poezitë i fillojnë me invokacion, falënderim Zotit dhe lavdim profetit Muhammed, p. sh. Nezimi shkruan se Divanin e ka nisur në emër të Zotit dhe dashurisë ndaj Tij, si dhe që zemra i rrah për profetin Muhammed:

*Bismil-lahi nisa divanë
Për sevda tënde ja Mevla,
Për Muhammed Mustafanë
Zemra rrate ja Mevla⁵.*

dhe pastaj në frymë të misticizmit islam, për të shprehur nënshtrimin e tij, pason bejti ku thotë se Nezimi nuk e do kënaqësinë dhe kërkon nga Zoti t'i jap mundim:

*Nezimi s'e do sefanë
Jepi xhefanë, ja Mevla.*

Ashtu sikur vepronin poetët e Orientit edhe bejtexhinjtë shqiptarë e ndoqën rrugën e tyre për të përdorur emra poetik (mahlas) dhe si zakonisht ata vetë e shpjegojnë në poezitë e tyre se cili është emri poetik i tyre e cili emri i vërtetë. Kështu vepron edhe më i madh i tyre Nezimi:

Benim mahlasëm Nezimdir^{}*

⁵ Vargjet e Nezimit i citojmë nga Divani i Nezimit që në dorëshkrim ruhet në Arkivin e Shtetit në Tiranë me signaturë F. 43, D. 2 dhe F. 43, D. 3.

Emrin e kam Ibrahim.

e kështu kishte vepruar edhe Muçi Zade autori i vjershës më të vjetër shqiptare me grafi arabe *Imzot, mos më lerë pa kave*, një lutjeje humoristike të përbërë nga shtatëmbëdhjetë strofa katërshe e cila daton nga viti 1725 e që përfundon me këto vargje:

*Lut-iu Zotit Muçi Zade,
se heq bari shumë derde,
se s'ke as pilaf as zerde!
Imzot, mos më lerë pa kave!*⁶

Kështu, duke lexuar poezitë e poetëve më të hershëm I. Nezimit, S. Naibit, H. Z. Kamberit, M. Çamit, Z. Bastarit, D. Frashërit, por edhe të atyre të mëvonshëm Tahir Boshnjakut, Dervish Salihut, Sheh Malës e të tjerëve mund të hetojmë se ata nga çdo aspekt janë nën ndikim të poezisë orientale-islame. Tek e fundit edhe te popujt e tjerë të islamizuar ishte vështirë të gjeje ndonjë poet krejt origjinal. Si shumë poetë turqë, edhe bejtexhinjtë shqiptarë ishin të ndikuar shumë nga poetët klasik të famshëm persian duke u përpjekur që mangësinë e ideve ta kompenzojë me virtuozytete gjuhësore e poetike.

Natyrisht me qëllim që lexuesi ynë të kuptoj më mirë poezinë mistike islame, duhet të paset me njohuri më të gjera rreth misticizmit islam-tesavufit, zhvillimit të tarikateve/rendeve dervish në botën islame e në Shqipëri për çka edhe kohëve të fundit kemi disa botime⁷.

Nuk ka dyshim që numri më i madh i poezive të bejtexhinjëve, duke filluar nga Nezimi janë të karakterit fetar, janë poezi mistike islame dhe del se misticizmi islam ishte karakteristikë dalluese për shumë shkrimtarë shqiptarë që shkruan me grafi arabe. Tek e fundit ata ishin formuar në këtë frymë, andaj edhe morali i tyre dhe përgjithësisht, mendimi që kanë për jetën dhe botën është i karakterit fetar-mistik islam. Kjo ndodh për shkak se të

* Emri im poetik është Nezim.

⁶ Cituar sipas: Osman Myderrizi, *Letërsia shqipe me alfabetin arab*, Buletini i shkencave shoqërore, 2 / 1955, (fq. 148-154). E kështu veprojnë gati të gjithë në gazelet e tyre ku në bejtin e fundit (makta) përmendin emrin e tyre ose edhe të dëlberit - murshidit të tyre.

⁷ Dr. Selçuk ERAYDIN, *Tesavufi dhe tarikatet*, Tetovë, 2001, f. 428; Jashar Rexhepagiqi, *Dervishët, rendet dhe teqetë*, Dukagjini - Pejë 1999, f. 282; Hans Joahim Kisling, *Derviški redovi i pučki islam*, SUFIZAM, Izdanje "Vuk Karadzić", Beograd, 1981, s. 118-126; Nedim Filipović, *Tasavvuf - islamski misticizam*, **Prilozhi za orijentalnu filologiju**, XXIV / 1974, Sarajevo 1976; Metin Izeti, **Tarikati bektashian**, Tetovë, 2001, f. 184; Baba Rexhepi, **Misticizma islame dhe Bektashizma**, Nju-Jork, 1970 dhe në Tiranë, 1995; Robert Elsie, *Islam and the dervish sects of Albania*, **The Islamik Quarterly** A Review of Islamic Culture, Volume XLII, Number 4, 1998, London, England, (fq.266-289), etj.

gjithë ata dijetarë islam të paisur me moral e dituri islame gjatë jetës janë marrë me përhapjen e këtij morali dhe këtyre diturive islame, dhe nga masa ata edhe janë konsideruar si persona të shquar në jetën fetare, sidomos ata që merreshin me doktrinën e misticizmit islam. Natyrisht që kjo nuk përjashton vetëdijen kombëtare, mbase edhe angazhimin e tyre jashtë vetëdijes fetare, si ai iluminist, patriotik e shoqëror.

Kjo poezi, e cila flet për moralin islam, për përsosjen shpirtërore, tek e fundit, reflekton edhe rrjedhat shoqërore që në atë kohë zhvilloheshin edhe nëpërmjet vetëdijes fetare. Dhe duke pasqyruar kështu edhe preokupimet e pakënaqësitë shpirtërore e fizike të masave fetare islame të cilave u dedikohej, ka shprehur në këtë mënyrë edhe nivelin e përgjithshëm shoqëro-ro-kulturor të kohës kur ka jetuar e vepruar poeti. Në fund të fundit, kjo ishte poezia e cila i përshtatej nivelit të vetëdijes fetare e kulturore të masës.

Pikërisht poezia mistike islame e bejtexhinjëve shqiptarë kujtojmë që më së paku është studiuar⁸. Ndërsa siç dihet si temë shumë e gjerë dhe komplekse "Misticizmi islam nuk mund të vështrohet i izoluar, si veprimtari e veçantë spirituale, por duhet të merret në kompleks të asaj çështje e cila quhet islam dhe civilizimi i tij"⁹.

Kështu, misticizmi islam është zhvilluar duke medituar dhe interpretuar temat e ndryshme Kur'anore, sidomos duke u thelluar në kuptimet e fshehta spirituale, që ndryshojnë nga kuptimet e dukshme e tekstuale, e nga kjo dalin edhe kuptimet themelore të misticizmit islam. Tema që më së shumti meditohej në misticizëm, padyshim ishte përsiatja e njohja e Zotit të gjithfuqishëm, i cili bën çka don, i cili është krijues i çdo gjëje dhe i cili është i përhershëm e i pambarim, përderisa të gjitha ato gjallesa e krijesa të Tij do të mbarojnë e shkatërrohen.

Dy janë aspektet në bazë të të cilëve mund t'i qasemi islamit: aspekti ekzoterik dhe aspekti ezoterik. Këto dy aspekte vijnë në shprehje që nga faza e parë e zhvillimit të islamit. Që të dy këta aspekte të qasjes ndaj islamit pretendojnë të kenë mbështetjen e vet në Kur'an dhe në traditën e profetit Muhammed (synnet)¹⁰. Kështu, si bartës të islamit egzoterik paraqiten dijetarët të cilët konsiderojnë që detyra themelore e çdo muslimani është t'i plotësojë normat religjioze dhe morale të përcaktuara në bazë të ligjit hyjnor -*shariatit*. Pra kjo anë e mendimit të të kuptuarit dhe të zbatuarit të fesë merret kryesisht me rregullat e jashtme të saj. Ndërsa dijetarët e islamit

⁸ Me sa dijmë analizën më të mirë rreth karakterit mistik të poezive të bejtexhinjëve e ka bërë Mr. Hajdar Salihu, shih: **Poezia e bejtexhinjëve**, "Rilindja", Prishtinë, 1987.

⁹ Nedim Filipović, *Tasavvuf - islamski misticizam*, POF, XXIV / 1974, Sarajevo, 1976, s. 13.

¹⁰ Më gjerësisht shih: Dr. Selçuk Eraydin, **Tesavvufi dhe tarikatat**, përktheu Metin Izeti, Tetovë, 2001.

ezoterik synojnë njohjen e Zotit. Dhe sipas tyre me respektimin e udhëzimeve praktike të shariatit mund të jesh në harmoni me hakikatin, por nuk mund të vish deri te njohja e Tij *-ma'rifa* e cila është njohje e të vërtetës absolute (hakikat). Të njohësh të vërtetën, sipas tyre, domethënë të njësosh me të, të jesh një me Allahun.

Gjithë kjo që u tha, na shërben të shpjegojmë kompleksin e realitetit historik e fetar nga të cilat do të dalë tesavufi, pra misticizmi islam i cili ekzistimin e vet e ka mbështetur në interpretimin ezoterik të islamit. Misticizmi islam orientohet kah mendimi i thellë, e i lirë, që nënkupton mësimin e brendshëm të fesë. Dhe tesavufi tash, pos anës formale të fesë, merret me esencën e saj, me hulumtimin e të padukshmes, të fshehtës, pretendon njohjen e së vërtetës, Zotit. Pikënisje e misticizmit islam është Tevhidi, mësimi për njëshmërinë e Zotit. Dhe, sipas misticizmit Zoti njihet me zemër e jo me mendje dhe mund të njihet vetëm atëhere kur uni njerëzor shlyhet pranë pambarueshmërisë së Zotit. Sipas përfaqësuesve të misticizmit, të njohësh të vërtetën domethënë të njësosh me të, të jesh një me Allahun. Dhe kështu fillon përhapja e rrymës së tesavufit që si fazë të hershme ka atë të shekullit VIII e pastaj fazë të zhvillimit të vet të theksuar atë të shekullit X -XII kur tashmë fillojnë të lindin rendet (tariketet) islame¹¹ dhe tashmë pos Sirisë, e Bagdadit, kjo frymë e të menduarit mistik islam kalon në Iran, Turqi e Indi dhe pastaj edhe në vise të tjera. Dhe në këtë mënyrë do të zhvillohet letërsia shumë e pasur sufiste e josufiste në të cilën ideologjia e tesavufit edhe tematikisht edhe artistikisht do të ndikoj thellë.

Po ashtu, shumë bejtexhinj shqiptarë kanë qenë ihtarë të ndonjë tarikati, jo vetëm për faktin se në shekujt XVIII e XIX shumë dijetar të dalluar kanë qenë pjesëtar të ndonjë tarikati mistik, por për faktin se një numër i madh i poezive të shumë bejtexhinjëve, jo vetëm që janë me karakter fetar, por thjesht kanë të gjitha karakteristikat e poezisë së misticizmit islam të shkruara sipas modelit të poezive mistike të kohës në të cilën krijohet. Në mesin e atyre poezive mistike, ka asosh me të cilat synohet të formësohet e të mbjellet te masat mendimi fetar dhe të njihen ata me rregullat fetare, mbi të gjitha me ato të tarikateve që mëtojnë që njeriun ta shpënë sa më afër pranisë së Perëndisë duke u përshkruar dervishëve mënyrën e rrugën të cilën duhet ta ndjekin, ku duhet të kalojnë nëpër shkallë

¹¹ Tarikat është shumës i fjalës Tarik që do të thotë: rrugë për të njohur Zotin, respektivisht zhvillimi praktik i jetës i plotësuar sipas rregullave dhe principeve të përcaktuara të asaj rruge. Çdo tarikat ka themeluesin e vet sipas të cilit edhe është emërtuar. Për tarikatat shih: Dr. Selçuk ERAYDIN, **Tesavufi dhe tarikatat**, Tetovë, 2001, f. 428; Jashar Rexhepagiq, **Dervishët, rendet dhe teqetë**", Dukagjini - Pejë, 1999, f. 282; Hans Joachim Kisling, *Derviški redovi i pučki islam*, në: **Sufizam**, Izdanje "Vuk Karadzić", Beograd, 1981, s. 118-126; Metin Izeti, **Tarikati Bektashian**, Tetovë, 2001, fq. 184 etj.

të caktuara. Prandaj të gjitha këto shkallë e faza kalohen me kujdes të veçantë dhe me mbikqyrje të udhërrëfyesit (murshidit) shpirtëror të cilit duhet t'i nënshtrohen bindshëm. Këto shkallë përshkruhen mirë në poezinë "Ah un i mjeri kesh tu fjet" të Dervish Hasanit:

*Ah, un i mjeri kesh tu fjet
e m'dul gjumi per ahiret,
Me ni myrshid jom perpjek,
çka m'kallzojti ah medet.*

*Ai mi çeli kater dyer,
njonda osht ah sheriat
Osht e dyta tarikat
dera tret hakikat;*

*Edhe njonda osht marifet
lumi ai qi e ka gjet.¹²*

Këto shkallë (sheriat, tarikat, hakikat, marifet), që dervishët duhet t'i kalojnë me devotshmërinë dhe adhurimin e tyre ndaj Zotit për të arritur shkallën e njeriut të përsosur, të pastër e të patëmëta dhe kështu të mund të arrihet te njohja e Zotit dhe te shijimi i bekimit dhe kënaqësisë së Tij, përshkruhen në poezi të shumë bejtexhinjëve.

Tesavufi përqëndrohet në mendimin për Zotin, në dëshirën që të arrihet afria e Zotit dhe mëshira e Zotit, të njihet Ai. Ndërkaq, Zoti mund të njihet vetëm në përputhje me fjalët "Nuk ka hyjni pos Zotit". Sipas mësimit sufist, organi me të cilin njeriu e njeh praninë e Zotit nuk është mendja, por është zemra. Tash si mjet për t'iu afruar Zotit është dashuria ndaj Zotit (mahabba/ashk). Në këtë dashuri kemi procesin metafizik të dashurisë së njeriut ndaj Zotit. Dhe dashuria e zjarrtë e mistikëve ndaj Zotit dhe avanturat e tyre shpirtërore të vuajtjes si metoda të të afruarit ndaj Zotit kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve. Dashuria te mistiku është si një medium jomaterial gjithpërfshirës dhe energji e takimit të njeriut dhe Zotit. Ndërsa mistiku me Zotin nuk njësohet (nuk bashkohet) substancialisht, por me anë të dashurisë, krejt deri te më e larta "Unë" nëpërmjet të dialogut të zemrës dhe Zotit. Pra kur mistiku e thekson varshmërinë absolute ndaj Krijuesit, lind kënaqësia kulmore e llojit të vet e vetëmohimit dhe të dëshmimit të Zotit me plot zell.

Po ashtu nga poezitë mistike të bejtexhinjëve tanë ka asosh në të cilat në veçanti trajtohet dashuria ndaj Zotit, dashuri e cila për mistikun është mënyra e drejtpërdrejtë për të arritur te njohja dhe përfytyrimi i Zotit e që pastaj të pasoj shlyerja e individualitetit të tij dhe njësimi me Zotin. Për këtë arsye Nezimi betohet se "Sirrë (fshehtësinë) e ashkut kush nuk e di / bil-lahi

¹² Cituar sipas: Muhamet Pirraku, *Gjurmë të veprimtarisë letrare shqipe me alfabet arab në Kosovë*, në: **DITURIA**, nr. 1-2, 1978, Prishtinë, fq. 91.

që s'është njeri", dhe sipas tij "ai që e mohon ashkun / nuk është insan, është gomar" dhe shkon deri atje sa që të tillin ta konsideroj pa iman:

*Një që shanë ashikërinë
Ka bërë inqar Perëndinë,
A s'e vritni faqezinë,
A s'e vritni!*

ose në të cilat përshkruhet mënyra e kryerjes së ritualeve mistike-dhikri (ziqri), të përmendurit e emrit të Zotit zëshëm duke u përcjellë edhe me muzikë e vallëzim që simbolizon aktin spiritual në rrugë të privimit të vetes, ku krijohet atmosfera e ekstazës mistike e cila sufijtë i shpie në rrugën e vetëshkatërrimit, në ndarjen e shpirtit nga trupi dhe kështu të arrijnë gjendjen e njësimimit me Zotin, përkatësisht njohjen e Zotit. Kështu Sheh Jonuzi shkruan:

*Me e dit nefsin, ziqr Zotin
Me e bo sabri osht ilaq,
Me nur të ziqrit shëndoshe zemrën
Ziqri daim është ilaq.¹³*

Dhikrin si ceremoni e ushtrojnë të gjitha tarikatet. Udhëtimi shpirtëror i sufiut sendërtohet vetëm nëpërmjet dhikrit. Dhe siç shkruan S. Eraydin, qëllimi i jetës së njeriut është arritja e përsosshmërisë dhe vështrimi i bukurisë hyjnore. Kjo përsosshmëri arrihet vetëm me ndihmën e dhikrit. Njerëzit që bëjnë dhikër dalëngadalë i braktisin kënaqësitë e kësaj bote dhe në zemër vendosin dashurinë ndaj Allahut xh. sh. Njeriu i cili e përkujton Allahun xh. sh. me qetësi shpirtërore në fund arrin gradën e ihsanit (bërja e ibadetit sikur e sheh Allahun) dhe afërsinë me Krijuesin.¹⁴

Cak i rrugës mistike, respektivisht i udhëtimit shpirtëror është tejkalimi i egos dhe kjo rrugë nuk mund të kalohet pa murshid/rehber (udhëheqës shpirtëror). Mistiku në këtë udhëtim shpirtëror futet pasi të jetë përgatitur mirë, pasi të jetë pastruar mirë zemra e tij. Ai duhet të jetë i vendosur, i durueshëm për t'i përballuar vështirësitë e ndryshme me të cilat ballafaqohet dhe t'i nënshtrohet udhëzimeve të murshidit të tij i cili në mënyrë graduale e shpie në shkallë të ndryshme shpirtërore. Dhe natyrisht se në këtë rrugë peripecitë janë të shumta sepse siç shprehet edhe Nezimi:

*Pa mos hequrë një mushkil
Kush u bë naili meram!*

që domethënë se askush nuk e arrin qëllimin pa vuajtur e hjekur mundime në rrugën për njohjen e Zotit.

¹³ Mr. Hajdar Salihu, *Poezia e bejtexhinjëve*, "Rilindja", Prishtinë, 1987, fq.299.

¹⁴ Dr. Selçuk ERAYDIN, *Tesavvufi dhe tarikatet*, Tetovë, 2001, fq. 117.

Ndërsa gjetja e murshidit për mistikun që do ta përcjell në udhëtimin e tij shpirtëror është e domosdoshme, kështu bejtexhiu Muharrem Mahzuni Babai thotë:

*Fshi lotët nga sytë
Dhe kërko mejdan,
● Shiko gjej myrshidin
Që të bën derman.¹⁵*

dhe mistiku duhet t'i nënshtrohet bindshëm udhërrëfyesit, apo mësuesit, sepse poqëse nuk e dëgjon dhe futet në udhëtim shpirtëror i mbështetur në iniciativën e vet, ai nuk do të arrij sukses kurrë dhe nuk mund të arrij synimin që të përrjetoj dritën e njohjes së Krijuesit. Këtë e kuptojmë edhe nga një strofë e një poezie të Nezimit ku shohim se një salik që është bërë anëtar i tarikatis dhe ka marrë rrugën e udhëtimit shpirtëror pa udhëzues ai nuk e di rrugën dhe mundohet ta gjej sipas mendjes së vet prandaj edhe e ka shumë të vështirë vendqëndrimin të cilin duhet kaluar gjatë udhëtimit shpirtëror:

Sot një salik u bë rahi*
Pa rehber* udhënë s'e di
Rreh ta gjenj me mend të ti
Mushkil menzili ti gajet*.*

Po ashtu te bejtexhinjtë tanë terminologjia e misticizmit është përdorur dendur që dëshmon për karakterin mistik të poezive. Prandaj për t'i kuptuar e interpretuar këto poezi duhet paisje e gjerë intelektuale islame, dhe sidomos njohje e zhvillimit të tesavufit dhe të tarikateve në botën islame, po edhe në trojet shqiptare, e në veçanti të njihen e të kuptohen nocionet e termat e shumtë, të cilët janë të lidhur ngushtë me misticizmin, respektivisht me tarikatatet. Ato nuk duhet marrë thjesht si fjalë leksikore, por më tepër si terme e nocione me kuptim të caktuar teorik e filozofik. Sepse këto terme, si edhe vetë praktika e ritualeve kanë të bëjnë me psikologjinë, etikën, filozofinë e religjionit, kulturologjinë, letërsinë dhe jetën e situatat shpirtërore, se ato janë simbole poetike. Dhe në doktrinën mistike simboli luan rol shumë të rëndësishëm për arsye se sipas mendimit të mistikëve, doktrina ezoterike mund të transmetohet vetëm me ndihmë të simbolit.

Arsyeja pse bejtexhinjtë shqiptarë shkruajnë poezi fetare, do parë në përgatitjen e tyre fetare si dhe te masa me të cilën komunikonin ata me poezitë e tyre nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, edhe në faktin se në kohën e tyre, poezia më e realizuar dhe më e kërkuar për masat e gjera popullore në

¹⁵ Mr. hajdar Salihu, *Poezia e bejtexhinjëve*, Prishtinë, 1987, f.237.

* Salik - pasues (anëtar) i një tarikati, udhëtari shpirtëror.

* Rahi - udhëtar.

* Rehber- udhërrëfyes.

* Mushkil menzili ti gajet - është i vështirë shumë vendqëndrimi i tij.

botën islame ishte poezia mistike me poetët e njohur të misticizmit, që ishin inspirim për poetët e ardhshëm të të gjithë popujt islam. Dhe, siç thamë, mëtim kryesor i poezisë së tesavufit ishte njohja e Krijuesit dhe e Islamit. Natyrisht, në rrugën e tyre të njohjes së Krijuesit të gjithësisë dhe Islamit poetët shqiptar janë nën ndikim të mistikëve të njohur të botës islame dhe të mësimëve të tyre, e kjo edhe do të ndikojë shumë në strukturën e poezisë së tyre. Këta poetë në poezitë e tyre moto kishin krijimin e njeriut të përsosur - *insani kamil*, njeriut me shpirt të pastër, me vyrtyte të larta morale, me kulturë e vetëdije të theksuar fetare islame duke besur se në këtë mënyrë do të mënjanoreshin veçoritë e këqija të njerëzimit. Ata pra synojnë një shoqëri ideale, një shoqëri të devotshme fetarisht e të pastër moralisht sipas rregullave që përcakton Islami. Ndërsa këto edhe ishin koncepte të përgjithshme në poezinë orientale islame. Këto ishin tema që dominonin në poezinë orientale islame, me forma vjershash e mjete të njohura stilistike të poetikës orientale.

Nga poezitë e disa bejtexhinjëve që mund t'i lexojmë nëpër veprat e studiuesve tanë, mund të shihet se ata i njihnin thellë disiplinat e dijes islame, problematikën e mendimit islam, sidomos thellimin e tyre në çështjen e transcendencës së Zotit, përfytyrimin e njohjen e Zotit që ishte bërë bosht i poezisë së misticizmit islam, ngase islami burimor ndalonte të menduarit e thellë rreth kësaj çështjeje duke u mjaftuar me ato që thotë Allahu për vete. Sidomos, vërehet ndikimi i klasikëve të njohur mistik si Xhami, Attari, Gazaliu, Hal-laxhi, Rumi, Emre, Fuzuli etj., si edhe i teknikës letrare të kohës, respektivisht i letërsisë orientale islame. Madje, jo që lehtë vërehen reflektimet dhe ndikimet e poezisë orientale, porse ato janë të shkruara si poezi shqipe e asaj shkolle, sepse lidhjet poetike të tyre me poezinë orientale-islame janë të natyrshme, madje edhe të pashmangshme, pasi që ata u shkolluan e u formuan në ato shkolla dhe në atë frymë. Kështu, jo vetëm që kompozicioni dhe forma në shumë poezi të tyre plotësisht u përgjigjen atyre të natyrës së këtillë të poetëve të tjerë mistik - oriental, por edhe pjesë të caktuara të poezive të tyre mistike, na dalin shumë të ngjashme me pjesë të poezive mistike turke, persiane e arabe. Prandaj integrimi i gjithanshëm i ndikimeve të përmendur, që mund të argumentohen qysh të krijimtaria e Nezimit, krijuesit më të hershëm të bejtexhinjëve që njohim sot, do të vërehen në tërë krijimtarinë e bejtexhinjëve që është pjesë përbërëse e letërsisë shqipe, dhe gjithësi këto ndikime duhet të merren edhe si tregues të nivelit të depërtimit të kulturës islame të intelektualët dhe të shtresat e gjera popullore shqiptare.

Dhe për fund, të themi se këto vepra, (veprat shqipe me grafi arabe) të cilat ende kanë mbetur të pabotuara, pos fragmentarisht, nga disa poezi të autorëve të caktuar, pa marrë parasysh kohën kur janë shkruar, kanë rëndësinë dhe peshën e vet, sepse tek e fundit i kanë kontribuar zhvillimit të mendimit shoqërorë, kulturës, e mbi të gjitha zhvillimit të letërsisë shqipe. Fundja, shumëllojshmëria e mendimit fetar e kulturor për çdo popull duhet të jetë begati, sepse ato shprehin aktivitetin e shpirtit njerëzor të popullit tonë dhe du-

het të kuptojmë se edhe këto vepra ishin veprimtari e shoqërisë sonë dhe gjithnjë kanë mëtuar që të mos jenë një tërësi e ndarë, por të jenë si një pjesë përbërëse e një tërësie kulturore, letrare shqiptare. Këtë jo rrallë e kanë theksuar në vargjet e tyre krijuesit e tillë. Qëndrimi i shoqërisë sonë ndaj kësaj pjese të letërsisë shqipe ka qenë inferior e mospërfillës. Ndërsa tashti rrethanat kanë ndryshuar, është krijuar realitet i ri në të menduarit dhe edhe kjo pjesë e letërsisë sonë ka filluar të trajtohet drejt e mbarë, dhe t'i jepet vendi që e meriton e që duhet ta ketë në tërësinë tonë letrare-kulturore.

Dr. Abdullah Hamiti

The themes of Islam mysticism in the poetry of folk poets

summary

The Albanian poetry written in Arabic alphabet arose in urban areas where intellectuals and literate people lived. Here we are considering the themes of Islam mysticism and some features of the impact of oriental Islam literature on the part of Albanian folk poets. This aspect has not been considered sufficiently given that our scholars have mostly dealt with the social and political activities of a writer rather than with his literary and artistic creativity.

The Albanian folk poets were excellent experts of Islam, culture and schools of the Islam opinion. They were well acquainted with the creativity of the classic Islam poets, the opinions and viewpoints of them are also reflected in literary creativity.

There is no doubt that the largest number of poems written by Albanian folk poets, starting from Nezimi, have a religious character. This is the case knowing that they were educated in this spirit and their moral or in general their opinion for life and the world is of an Islam character. The motto of this Islam mystic poetry was to create a perfect man, with a spirit, virtues, culture, and a high Islam religious conscience. This being the spiritual path to learn about God.

The poetry of the folk poets was impacted by the Islam oriental poetry. Therefore, they are indicators of the Islam cultural level of intellectuals and overall levels of the then society. It is worth mentioning that the poetry of the folk poets is important for us given that it has contributed to the development of the social opinion, culture and development of the Albanian literature.-kulturore.

